



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 15.12. 2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosilović, zëvendëskryetar i dytë, Xhelal Sveçla, Drita Millaku, Ismet Beqiri, Fatmir Xhelili, dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Mungoi: Ramiz Kelmendi, Fadil Beka dhe Blerim Kuçi

Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme: Flamur Sefaj- Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Lulzim Ejupi-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Shaban Guda-Policia Kufitare, Rashit Qalaj-Drejtorja e Operacioneve, Policia e Kosovës, Dardan Kocani- UD-Departamenti i Integriteteve, Ministria e Punëve të Brendshme, Bekim Hoxha, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrim Civil.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Drita Perezic-ICITAP, Dhurata Kryeziu-OSBE, Luanda Domi-DCAF

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtura me datë 04.12.2017;
3. Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme z.Flamur Sefaj rreth zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe Marrëveshjeve të Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.06/L-026 për Azil;
5. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtura me datë 07.11.2017 dhe 14.11.2017.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme z.Flamur Sefaj rreth zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe Marrëveshjeve të Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë.

Kryetari, theksoi se qëllimi i këtij takimi është që të raportohet nga ana e Ministrit rreth zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe më pas marrëveshjeve të Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë, fjalën ia kaloi z.Flamur Sefaj-Ministër i MPB-së.

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, fillimisht theksoi se parimi i transparencës është ai me të cilin do të funksionoj ky institucion dhe njoftoi që dje me datë 14 dhjetor është aprovuar kërkesa nga EUROPOL për nënshkrimin e marrëveshjes me Kosovën, duke theksuar që kjo është shumë e rëndësishme. Ndërsa sa i përket aspekteve të zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së(tutje PKZMSA), theksoi që për vitin 2017, Ministria ka planifikuar 98 masa, nga të cilat 14 masa legislative dhe 84 masa zbatuese, 2 masa janë planifikuar në kapitullin e 14(politika e transportit), shtatë masa janë planifikuar në kapitullin 23(gjyqësori dhe të drejtat themelore), 88 masa janë planifikuar në kapitullin e 24(drejtësia, liria dhe siguria) dhe një masë është planifikuar në kapitullin e 27(mjedisi).

Më tutje theksoi që përgjatë periudhës 1 janar deri 15 dhjetor 2017, nga katërmbëdhjetë masa legislative të planifikuara nga MPB-ja, 5 masa janë përfunduar ndërsa 9 masat e tjera janë rrugës për tu realizuar, 7 prej tyre janë akte nënligjore, që nuk mund të miratohen pa aprovimin e ligjit për Azil dhe për të Huajt në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa nga 84 masa zbatuese të planifikuara, 72 masa janë përfunduar, 12 janë në realizim e sipër. Prej 84 masave zbatuese, të planifikuara në kuadër të PKZMSA-së, 85 janë masa që adresohen në vazhdimësi dhe raportohen përmes të dhënave statistikore. Në përgjithësi, nga 98 masat që ministria është përgjegjëse, deri më tani

janë realizuar 77, ndërsa 21 janë në realizim e sipër. Gjithashtu theksoi se nga muaji shtator ka filluar procesi i rishikimit dhe është finalizuar PKZMSA-së për vitin 2018, në harmoni të plotë me planin vjetor të Ministrisë së MPB-së, duke shtuar se këto të dhëna do të dërgohen deputetëve të Komisionit.

Rexhep Selimi, shtroi pyetjet në vijim për Ministrin: Cilat janë sfidat në zbatimin e PKZMSA-së? Çka nuk është realizuar? Gjithashtu uroi për marrëveshjen e arritur për nënshkrimin e marrëveshjes me EUROPOL-in, duke theksuar nevojën që edhe në organizatat e tjera policia të bëhet pjesë. Gjithashtu ngriti edhe çështjen e tërheqjes së aplikacionit për anëtarësimin në INTERPOL, për të cilën gjë nuk është sqaruar.

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me pyetjet e bëra, theksoi që projektligjet janë proceduar në Kuvend, përveç ligji për të Huajt. Gjithashtu theksoi që ka stagnim në aktet ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me këto projektligje, pro që ngecjet janë më shumë teknike. Ndërsa sa i përket çështjes së INTERPOL-it, theksoi se ka qenë deklarata zyrtare që është dhënë, pasi ashtu kanë qenë numrat. Po ashtu theksoi se është formuar grupi punues për këtë çështje, duke vlerësuar si të nevojshme anëtarësimi i Policisë së Kosovës në këtë organizatë.

Fatmir Xhelili, lidhur me zbatimin e PKZMSA-së, shtroi pyetjet si në vijim: A ka identifikuar ekipi i Ministrisë të gjitha masat dhe nëse janë drejtë të identifikuara? Detyrat dhe masat që ka obligim Ministria të zbatoj, a varen nga resorë të tjerë? A është identifikuar që resorët e tjerë janë pengesë për realizimin kohor për zbatimin e masave për aktivitetet që duhet zbatuar? A ka pasur vështirësi financiare për zbatimin e masave të parapara për resorët e MPB-së? Gjithashtu shtoi se, nga vizita që kanë pasur disa anëtar të Komisionit në një pikë kufitare me Serbinë(pika Kapi-Sfircë), nuk ka furnizim me energji elektrike, kjo ndoshta si mungesë e financave.

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me zbatimin e masave, theksoi që ato të cilat nuk do të mund të realizohen në këtë vit, do të bartën për vitin 2018. Ndërsa sa i përket financave, theksoi që nuk është paraqitur ndonjë problem financiar që nuk është paraparë në buxhet, por më shumë kanë qenë probleme praktike. Ndërsa sa i përket pikës kufitare në Kapi, theksoi se kërkesa është bërë me vonesë për dërgimin e rrymës deri në atë pjesë. Gjithashtu theksoi se ka bërë vizitë në këtë pikë, por shpresoi që shpejt do të rregullohet. Ndërsa sa i përket pikave të tjera, theksoi se janë disa pengesa, sidomos në pikën në Bernjak, pasi është e nevojshme dislokimi i një kabloje të tensionit të lartë për të filluar ndërtimet e objekteve të reja, duke theksuar që si Ministri kanë reaguar menjëherë.

Fatmir Xhelili, lidhur me aktivitetet e Policisë së Kosovës, theksoi të dhënat janë evidente për sukseset e saj, por gjithashtu posedojnë të dhëna për aktivitetet jo ligjore. Për këtë arsye shtroi çështjen, se është në disproporcion numri i rasteve që procedohen nga Policia në Prokurori dhe nga ato lëndë që Prokuroria ngrit ose nuk ngrit padi, është një disproporcion i madh. A është në pyetje që provat nuk janë të mjaftueshme për të qenë dëshmi e suksesshme? Apo është çalim i Prokurorisë që nuk i merr për bazë dhe nuk e udhëheq procesin? A bëhen analiza të këtyre të dhënave, se sa merren për bazë nga prokuroria?

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi se disproporcioni është i dallueshëm, ndërsa sa i përket Prokurorisë, theksoi se duket se diçka stagnon. Për këtë qëllim, ndoshta do të fillohet një bashkëpunim më i mirë me ministrinë e Drejtësisë dhe Kryeprokurorin e Shtetit, për të parë stagnimet dhe disproporcionin e kësaj çështje.

Rashit Qalaj-Drejtoria e Operacioneve, Policia e Kosovës, lidhur me çështjen e ngritur nga z.Xhelili, theksoi se është e vërtetë që nga ana e Policisë së Kosovës, ngritët një numër i madh të kallximeve penale, për vepra të ndryshme penale dhe dërgohen në prokurori, mirëpo Prokurori është ai që udhëheq hetimet dhe vazhdimësinë e hetimeve për kërkimin e informatave shtesë. Tutje theksoi se bashkëpunimi me Prokurorinë është i mirë, dhe meqenëse janë ngritur kapacitete për hetime, theksoi se janë në proces të harmonizimit të bazës së të dhënave, pasi deri më sot, Policia, Prokuroria dhe gjykatat e kanë pasur bazën e të dhënave të veçanta dhe nuk ka pasur komunikim të mirë për lëndët, duke shpresuar që tutje bashkëpunimi do të jetë më i mirë. Gjithashtu theksoi se është Prokurori që vendos për fatin e një hetimi, duke shtuar që janë në rrugë të mirë që të ngritët bashkëpunimi edhe me Prokurorinë.

Drita Millaku, shtroi çështjen e të punësuarve në Drejtorin e Përgjithshme të Policisë, me theks të veçantë të personelit të uniformuar, ndërkohë që punët që bëjnë janë më tepër të natyrës administrative, ndërkaj në anën tjetër në patrullat e policisë ka mungesë të policëve në uniform, për mbulimin e çështjeve të ndryshme. A është paraparë diçka në këtë drejtim për vitin 2018, nëse jo, a do të planifikohet për vitet në vijim që të rregullohet kjo çështje?

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjes së znj.Millaku, theksoi se janë duke u marrë me këtë çështje, pasi policia ka avancuar në moshë. Është proceduar Projektligji për pensionimin e pjesëtarëve të policisë që do të rregulloj këtë çështje. Gjithashtu theksoi se janë 600 zyrtar policor që janë të angazhuar në ruajtjen e objekteve të ndryshme qeveritare, dhe po ashtu kërkoi përkrahjen e Komisionit për procedimin tuje të Projektligjit për pensionimin pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, duke theksuar që aktualisht është i bllokuar në Ministrinë e Financave nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, pasi konsiderohet që ka kosto të lartë dhe mund të shkaktoj disbalancë financiar, duke e vlerësuar si shumë të nevojshme kalimin e këtij projektligji.

Rashit Qalaj-Drejtoria e Operacioneve, Policia e Kosovës, lidhur me çështjen e ngritur, theksoi se ka një numër të madh të stafit që punojnë në çështje administrative, duke theksuar se përveç pengesës së miratimit të Projektligjit për pensionimin e pjesëtarëve të policisë, ka edhe pengesa të tjera. Tutje theksoi se krahas numrit të policisë, janë marrë edhe obligime shtesë ndërkohë numri nuk është rritur, gjithashtu theksoi se edhe marrëveshja e Brukselit ka ndikuar në numrin e policëve, pasi çdo pikë kufitare që hapet duhet të mbulohet, njësia për mbrojtjen e trashëgimisë fetare, ku gjithsej janë të angazhuar 207 polic. Gjithashtu ka ndikuar edhe krijimi i njëjësive përbrenda policisë, po ashtu nevojën për mbështetje dhe ofrimin e sigurisë përgjatë aktiviteteve sportive, apo asistimin e kuvendeve komunale, inspektorët e ndërtimit etj., duke shtuar që në disa raste nuk arrijnë të kryejnë punë për të cilën janë thirrur. Ndërsa sa i përket moshës mesatare të Policisë, është 44.6 dhe konsiderohet e vjetër, problemet shëndetësore e konsideroi të nevojshëm miratimin e ligjit për pensionimin e prestarëve të policisë.

Rexhep Selimi, sa i përket çështjes së procedimit të Projektligjit për pensionimin e pjesëtarëve të policisë, theksoi se problematika e parë është pengesa financiare. Sugjeroi që të negociohet me Ministrinë e Financave, ndërsa përkrahje e Komisionit nuk do të mungoj. Ndërsa sa i përket angazhimit të policisë në aktivitete të ndryshme, si përcjelljes së aktiviteteve sportive apo të tjera, theksoi se kjo çështje do të mund të rregullohej me legjislacion sekondar ose angazhimi i kompanive private të sigurisë.

Kryetari, propozoi që nëse nuk ka pyetje të tjera rreth zbatimit të Planit Kombëtar për MSA, të vazhdohet nga ana e ministrit ose zyrtar të tjerë të ministrisë për të raportuar lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë.

Lulzim Ejupi-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me marrëveshjen për lëvizjen lirë, theksoi se në vitin 2016 është integruar pjesa e veriut të vendi, ku janë hapur katër qendra të regjistrimit dhe pajisje me dokumente, në Zveqan, Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicën Veriore, janë integruar 32 zyrtar nga komuniteti serb. Më tutje theksoi se si sfidë e konsideron fushën në gjendjen civile, pasi përveç shërbimeve që kryhen në Qabër, Lipë, edhe Bistricë e konsideroi të nevojshme që në të ardhmen të hapen edhe qendrat në Leposaviq, Zveqan dhe pjesën veriore për gjendjen civile. Ndërsa sa i përket çështjes së tabelave, theksoi se ka qenë marrëveshja për stikersa, ku ishte paraparë afati, theksoi se nuk ka qenë e lehtë, pasi është provuar që nga buxheti i Ministrisë të mbulohen disa shpenzime, duke shtuar që aktualisht i kanë stikersat për një periudhë gjashtë mujore, kurdo që merret vendimi për marrëveshje reciproke.

Kryetari, lidhur me zbatimin e marrëveshjes për lëvizjen e lirë të qytetarëve shtroi pyetjen; Sa është duke u zbatuar kjo marrëveshje nga pala serbe, për targat apo elemente të tjera?

Lulzim Ejupi-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjes së z.Shala, theksoi se kanë disa të dhëna se afërsisht janë të regjistruar 50.000 persona, por nuk i kanë të dalluara nga cili komunitet. Për momentin kushdo që i plotëson kushtet mund të regjistrohet.

Fatmir Xhelili, shtroi pyetjen si në vijim: Sa qytetar të veriut të vendit kanë pasaporta dhe letërnjoftim të Kosovës?

Bekim Hoxha, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrim Civil, për çështjet e ngritura, theksoi se Agjencia ka një bazë të të dhënave, ku sipas atyre del që mbi 50.000 qytetarë janë të pajisur me dokumente nga Republika e Kosovës, qytetarë janë nga komunitete serb, shqiptar dhe të tjerë.

Rexhep Selimi, lidhur me marrëveshjet e arritura mes Kosovës dhe Serbisë, theksoi se si grupi parlamentar të cilit i parket i ka kanë kundërshtuar dhe vazhdojnë të kundërshtojnë procesin e negociatave në Bruksel. Më tutje theksoi se do të fokusohet në pasojat e këtyre marrëveshjeve, duke shtuar se çështja e stikersave nuk është aq çështje financiare sa mos gatishmëria për mos zbatimin e tyre nga njëra palë. Gjithashtu theksoi se çështja e lëvizjes së lirë është në favor të qytetarëve serb dhe në dëm të qytetarëve të Kosovës, pasi as sot nuk jemi në pozitë të njëjtë, pasi qytetarët serb mund të hyjnë me veturë me targa të shtetit të tyre në Kosovë, ndërsa nuk ndodh e

kundërta. Gjithashtu theksoi se në disa raste institucionet e Kosovës po janë të pa drejtë në raport me qytetarët e Kosovës. Po ashtu theksoi se në Kosovë qarkullojnë edhe targa ilegale(si KM, PR), gjithashtu targat KS dhe RKS. Tutje shtroi pyetjet: Deri kur do të lëshohen targat KS? Çfarë ndërmerr policia kur has në rastet kur ka targa ilegale?

Lulzim Ejupi-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me çështjet e ngritura, theksoi se çfarëdo që merr vendim Qeveria, si ministri janë të obliguar të zbatojnë. Ndërsa sa i përket stikersave, theksoi se duhet të jenë të standardeve ndërkombëtare. Ndërsa sa i përket tabelave, theksoi se janë bërë dhe po bëhen përpjekje për integrimin e komunitetit serb në veri.

Bekim Hoxha, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrim Civil, lidhur me çështjet e ngritura theksoi se, në bazë të marrëveshjes së arritur në vitin 2016, edhe për pesë vite do të vazhdoj furnizimi me tabela KS për qytetarët e interesuar.

Fatmir Xhelili, shtroi pyetjen si në vijim: A ka të drejt, i njëjti qytetar të posedon dy lloj të tabelave, psh.RKS dhe KS?

Bekim Hoxha, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrim Civil, në përgjigjeje të pyetjes së z.Xhelili, theksoi se qytetarët nuk kanë të drejtë të posedojnë dy llojet e tabelave.

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, shtoi se, sa i përket çështjeve të ngritura për tablat, stikersat janë duke zbatuar marrëveshjet në të cilat Kosova ka qenë pjesë dhe i ka nënshkruar. Ndërsa intervenimet radikale nuk janë të mundura dhe nuk do të bëhen.

Zoran Mojsilović, theksoi se i vjen mirë që ka mirëkuptim, për integrimin e komunitetit serb dhe përmbushjen e marrëveshjeve të arritura. Tutje shtoi se personalisht jeton në veri të vendit dhe se numri më i madh i targave është RKS dhe qarkullojnë pa problem në atë pjesë dhe kanë ndihmuar në lëvizjen e lirë dhe kjo gjë është pranuar në dialogun Prishtinë-Beograd.

Gjithashtu theksoi se dikujt mund të mos i duket në rregull, por që marrëveshja për targat është duke u zbatuar dhe gradualisht edhe popullata në veri do të pranoj marrëveshjet.

Tutje shtroi pyetjen si në vijim: Sipas të cilave marrëveshje dhe kriteret të BE-së, janë hapur pikat kufitare(p.sh.Bërnjak etj) pasi nuk përmenden në Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror, i cili si projektligj është në plotësim ndryshim në Komision.

Gjithashtu theksoi që Lista Serbe, ka propozuar disa amendamente për këtë çështje për Projektligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror, si pjesë e marrëveshjes së Brukselit të inkorporohet në ligje. Duke shtuar që pasi tentohet të bëhemi pjesë e BE-së, pse të ndryshohen ligjet shpesh, duke konsideruar që marrëveshjet e Brukselit, duhet të përfshihen në ligje. Ndërsa sa i përket çështjes së tabelave, theksoi se do të rregullohet sikur të përshpejtohet procesi i dhënies së dokumenteve.

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjeve të ngritura nga z.Mosilović, theksoi se të gjitha ligjet bëhen në përputhje me direktivat e BE-së dhe bëhen në përputhje me rregullat e schengen-it. Ndërsa sa i përket vendosjes së pikave kufitare, theksoi se janë bërë për çështje praktike, duke kërkuar mbështetjen e komunitetit serb që jeton në

veri. Ndërsa sa i përket dhënies së dokumenteve theksoi se qëllimi i tyre si ministri është që të pajisen të gjithë me dokumente.

Xhelal Sveçla, duke shtuar që grupi parlamentar që i përket, GP Vetëvendosje, që nga fillimi ka kundërshtuar marrëveshjet e Brukselit, theksoi se këto marrëveshje kane degraduar për çështjet për të cilat u diskutuar, siç është lëvizja e lirë. Gjithashtu theksoi që përveç negociatorëve, edhe zbatuesit e marrëveshjeve janë kontribuues në degradimin e sovranitetit të Kosovës. Tutje shtroi pyetjet: Sa kanë kushtuar stikersat për Ministrinë e Punëve të Brendshme? Cilat janë nevojat dhe pengesat, për të cilat Komisioni do të mund të ofronte mbështetjen? Pse nuk janë hapur qendrat e regjistrimit civil në zonat urbane në veri, pro vetëm në fshatra? Cila është periudha kohore që vlen vendosja e stikersave, vetëm në hyrje në kufi apo në gjithë territorin? A ka direktiva për policinë e trafikut, që nëse hasin vetura me targa nga shteti serb, nëse kanë mungesë të stikersave, çfarë masa duhet ndërmarrë? Kur do të filloj zbatimi i marrëveshjes së stikersave? Gjithashtu ngriti edhe çështjen që Serbia, nuk i lejon qytetarët e vendeve të treta, të futen në Serbi nëse kanë hyrë përmes Kosovës. A implementohet reciprocitet për këtë rast? Pasi me këtë masë të një anshme nga Serbia, i shkaktohet dëm ekonomik dhe politik Kosovës.

Lulzim Ejupi-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjes së z.Sveçla, për stikersat, theksoi se kanë kushtuar 296.000euro dhe janë paraparë për një periudhë gjashtë mujore. Ndërsa për qendrat civile theksoi se, çështja e hapjes së tyre është në kompetencën Ministrisë së Administratës Publike, ndërsa nga ana e MPB-së, kërkohet vetëm trajnimi i zyrtarëve. Ndërsa sa i përket zbatimit të marrëveshjes së stikersave, theksoi se nuk ka filluar të zbatohet ende, por kur të filloj aplikimi i tyre do të barten në gjithë territorin. Ndërsa sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshje, theksoi se kur të filloj dialogu, dot merret vendimi për datën e zbatimit të saj.

Shaban Guda-Departamenti për Kufi, Policia e Kosovës, lidhur me çështjet e ngritura nga z.Sveçla, theksoi se marrëveshja për lëvizjen e lirë në mes Kosovës dhe Serbisë, parasheh që dokumenti për kalimin e pikës kufitare për shtetasit e Kosovës dhe Serbisë do të jetë letërnjoftimi, dhe kjo aplikohet nga viti 2011, ndërsa për të miturit aplikohet certifikata. Ndërsa sa i përket çështjes së mos pranimit të shtetasve të vendeve të treta, theksoi se kjo gjë nuk ka qenë pjesë e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes dhe kjo çështje do të adresohet në takimet e ardhshme.

Xhelal Sveçla, shtoi se nuk ka marrë përgjigjeje për këto çështje: Pse nuk zbatohet reciprociteti? Pse është e nevojshme të diskutohet dhe bisedohet për kalimin ose jo të palëve të treta? Çka ka ndërmarrë MPB-ja, që të siguroj që Kosova dhe Serbia janë të barabarta dhe kanë reciprocitet në këto çështje? Tutje theksoi se do të ishte e mirë, sikur zyrtarët e shtetit që janë të thirrur për këtë punë të mbrojnë interesin e shtetit dhe mos të pretendohet si në vitet e 90, të pretendohet se kemi shtet, ku në fakt realisht ky shtet nuk është. Për këtë arsye kërkoj që maksimalisht të jepet kontributi i zyrtarëve të shtetit, duke mos vazhduar në vazhdimësi me çështje të tilla, duke minimizuar dështimet që janë të dukshme.

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, sa i përket çështjes së reciprocitetit, theksoi se disa principe janë duke u aplikuar. Tutje theksoi se politika e MPB-së

është që të aplikon politika pozitive të reciprocitetit dhe jo konfliktuoze. Ndërsa sa i përket krahasimit me vitet e 90, theksoi se nuk është në rregull, ndërsa sa i përket qasjes theksoi se është konstruktive, duke shtuar që respekton të gjitha rregulloret dhe është në mbrojtje të interesit të vendit.

Ismet Beqiri, lidhur me çështjet e ngritura, theksoi se sovranitet të plotë nuk është se kanë të gjitha shtete, pasi në Kosovë është i pranishëm komuniteti ndërkombëtar. Gjithashtu vlerësoi punën e Policisë së Kosovës. Lidhur me çështjen e tabelave, theksoi se nuk janë të mira as për syrin dhe ligjin dhe tutje shtroi pyetjen. Pse është aktive marrëveshja për prodhimin e targave KS deri në vitin 2021? Ndërsa sa i përket viteve 90-ta, theksoi se Kosova ke qenë shtet, ndërsa sot jemi të njohur edhe ndërkombtarsisht, duk kërkuar që të gjithë duhet sjellur në mënyrë të përgjegjshme, duke shtuar se ka vërejtje se pse disa marrëveshje të arritura nuk po realizohen, dialogu stërzgjeten, duke shtuar që përveç dialogut nuk ka alternativë tjetër.

Kryetari, tutje ftoi Ministrin që të raportoj lidhur me zbatimin e marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufijve, e njohur si IBM.

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me zbatimin e marrëveshjes së IBM, theksoi se sa i përket pikës kufitare në KAP-i mbetet ende jo funksionale, për shkak të mos furnizimit me energji elektrike. Tutje shtoi se për këtë është kërkuar nga KEDS kyçja. Ndërsa sa i përket pikave kufitare në Merdare dhe në Mutivodë, janë duke u ndërtuar dhe priten të funksionalizohen në shtator të 2018. Ndërsa sa i përket pikës në Bërnjak, theksoi se është një problem teknik, sa i përket bartjes së kabllos, dhe nga ana e institucioneve të Kosovës janë duke u bërë përpjekjet e duhura.

Rexhep Selimi, propozoi që marrëveshjes së menaxhimit të integruar të kufirit ti referohemi në gjuhën shqipe, si MIK, dhe jo IBM, pasi shpeshherë B, për disa është border e për dikë bondering, dhe kërkoi që ti referohemi si MIK. Tutje shtroi pyetjen: A ka dalë ndonjë problem rreth zbatimit të marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufijve, para se të ndodhë demarkacioni i kufirit me Serbinë?

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyetjes ë z.Selimi, theksoi se vendosja e pikave kufitare dhe MIK është pozitive për Kosovën, duke shtuar që është obligim respektimi i saj.

Fatmir Xhelili, lidhur me marrëveshjen për menaxhimin e integruar të kufirit, theksoi se kjo marrëveshje nuk nënkupton vetëm relacione me Serbinë dhe e rëndësishme për institucionet tonë është koordinimi i aktiviteteve që përfshihen në menaxhimin e integruar të kufirit. Tutje shtroi pyetjet: Cili është niveli i koordinimit të aktiviteteve të Policisë, Doganës, Agjencionit të Ushqimit dhe komponentëve e të tjera? A ka nevojë për përkrahje të institucioneve të tjera, që ky koordinim me qenë në nivel? Tutje shtoi, se përkundër vendosjes së masave, flitet që kufiri është i lirë për qarkullim të lirë të njerëzve dhe mallrave, por edhe të kontrabandës dhe mallrave që nuk doganohen. A ka të dhëna, që në kufi kalojnë mallra, që nuk i nënshtrohen procesit të doganimit?

Shaban Guda-Departamenti për Kufi, Policia e Kosovës, theksoi se koncepti i menaxhimit të kufirit është i rregulluar me rregulloren e Këshillit Evropian të vitit 2006, si praktikë e mirë për kontrollin kufitar. Marrëveshja përcakton standardet e kontrollit kufitar dhe mënyrën e bashkëpunimit por edhe këmbimin e informatave në këto pika. Më tutje theksoi se me Serbinë janë gjashtë pika të kalimit dhe janë në proces të hapjes së dy pikave të kalimit, me qëllim të lehtësimit të qarkullimit. Gjithashtu theksoi se, kjo marrëveshje zbatohet ashtu siç është e paraparë, duke shtuar që kanë kontakte të rregullta me palën serbe dhe takime të rregullta javore. Ndërsa sa i përket pikave kufitare, theksoi se janë të përcaktuara dhe se komisionet e të dy shteteve me ndërmjetësimin e Komisionit Evropian kanë përcaktuar saktë pikat e kalimit të kufirit.

Ndërsa sa i përket bazës ligjore që rregullon këtë fushë, theksoi se është strategjia, ligji për bashkëpunimin mes agjencive në menaxhimin e integruar të kufirit. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit, theksoi se është një bashkëpunim pozitiv, ndërsa sa i përket kontrabandës, theksoi se ka, në tërë kufirin e Kosovës, duke shtuar që nga Serbia janë kryesisht mallra të konsumit të përditshëm, vajra dhe derivate. Po ashtu theksoi se kufiri Kosovë-Serbi ende është mandat i KFOR-it dhe policia bashkërisht veprojnë dhe bëjnë përpjekje për luftimin e kontrabandës.

Xhelal Sveçla, theksoi se ka qenë në pikën kufitare në Kapi dhe nga stafi në këtë pikë kufitarë, i është thënë që kërkesa për kyçje me rrymë nga KEDS-it i është bërë pesë muaj më herët. Tutje theksoi që duke qenë se në procedurë është Projektligji për Infrastrukturën Kritike, duhet të merren në konsideratë edhe këto çështje. Tutje shtoi pyetjen. Cilat janë kompetencat e shtetit për tejkalimin e problemit në këtë pikë kufitare? Gjithashtu e njëjta problematikë është edhe në pikën kufitare në Bërnjak, ku problematike është paraqitur dislokimi i kabllos. A është problem buxheti, çështja e sigurisë apo problematik tjetër dhe si do të tejkalohet?

Flamur Sefaj-Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me çështjet e ngritura, theksoi se personalisht ka qenë dhe është interesuar, duke shtuar që i është thënë që vonesa ka qenë nga ana e firmës private ndaj KEDS e cila ka qenë e kontraktuar për mirëmbajtjen e asaj pjese. Ndërsa sa i përket pikës kufitare në Bërnjak, theksoi se është problem teknik por mund të përdoret si problem politik, pasi dislokimi i kabllos duhet të bëhet dhe kjo në bashkëpunim me autoritetet e komunës së Zubin Potokut.

Zoran Mojsilović, sa i përket lidhjes me energji elektrike të pjesës veriore, theksoi se të gjithë në këtë pjesë janë të lidhur me Serbinë qendrore dhe nuk e ka idenë se nga vijnë borxhet për shpenzimet e energjisë elektrike. Gjithashtu theksoi se në media ka qenë çështja e borxheve për energjinë elektrike në pjesën veriore, dhe shtoi se do të ishte mirë që ndonjë firmë të merret me këtë çështje. Ndërsa sa i përket simboleve shtetërore në kalimet kufitare, theksoi se në Projektligjin për Kontrollin e kufirit shtetëror, detyrimet e marra nga palët në marrëveshje nuk janë të përfshirë në ligj. Gjithashtu shtoi pyetjen. Kompanitë që ofrojnë furnizim me energji, ku duhet të regjistrohen?

Po ashtu theksoi se e vlerëson si pozitive hapjen e qendrave për dhënien e dokumenteve në veri, duke shtuar që do të jenë funksionale dhe të gjitha librat me të dhënat do të bartën, duke shtuar që qytetarët e Mitrovicës së veriut janë të kënaqur me këtë çështje.

Ismet Beqiri, lidhur me deklarin e z.Mojiloviq, për regjistrimin e disa kompanive që ofrojnë rrymë, theksoi se nëse do të regjistroheshin do duhej ti nënshtroheshin legjislacionit të Kosovës. Kryetari, falënderoi Ministrin dhe stafin e tij për këtë prezantim dhe bashkëpunimin e treguar.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.06/L-026 për Azil.

Kryetari, njoftoi për këtë projektligj dhe propozoi votimin e tij, për të proceduar tutje.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet në parim Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.06/L-026 për Azil. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për tu proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.

1. Të ndryshme.

Kryetari, njoftoi që nga Asambleja Parlamentare e NATO-s, janë ftuar për të marrë pjesë në programin trajnues për delegacionin e Kuvendit të Kosovës i cili do të mbahet në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel, Belgjikë me datë 28-31 janar 2018. Janë kërkuar tre anëtarë të Komisionit dhe njëri nga ta nga komunitetet. Propozoi që në këtë delegacion nga Komisioni të marrin pjesë, Kryetari dhe dy zëvendës kryetarët e Komisionit.

PËRFUDNIM

Propozimi i Kryetarit u mbështet që, pjesëmarrës në programin trajnues për delegacionin e Kuvendit të Kosovës i cili do të mbahet në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel, Belgjikë me datë 28-31 janar 2018, të jenë z.Haxhi Shala-Kryetar, Rexhep Selimi-zëvendës Kryetar i parë dhe Zoran Mojsiloviq , zëvendës kryetar i dytë.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala